

Subjekti: KELI INERTE" SHPK

Raport teknik

19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Tirane 2024

Aktiviteti ne studim ne baze te Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis',
klasifikohet ne:

SHTOJCA I.

Shtojca I. 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Te dhena per shoqerine

Shoqeria "KELI INERTE" sh.p.k eshte person juridik i regjistruar ne QKR Tirane, me administrator zotin Klaudio Luca, me adrese Lagjia "3 Heronjtë", Rr. "Gerej", Nd.18, H.6, Ap.20, Shkoder.

1.b- Pershkrimi i kapaciteteve teknike

Shoqeria do te angazhoje ne kryerjen e veprimtarise minerare sipas legjislacionit ne fuqi punonjes te kualifikuar qe jane marre me kete lloj veprimtarie duke synuar kapacitete teknike qe realizojne nje shfrytezim optimal dhe ne perputhje me rregullat teknike qe egzistojne per kete qellim.

Ajo do te tregojte kujdes ne zgjedhjen e punonjesit kualifikuar qe merren me proceset e punes si shfrytezimin e gurit gelqeror me karriere, si dhe veçanerisht stafin teknik perkates.

Bashkelidhur me kete projekt do te jete edhe dokumentacioni qe tregon kualifikimin e pesonelit teknik qe eshte ne marredhenie pune sipas legjislacionit te punes ne fuqi me shoqerine "KELI INERTE" sh.p.k.

2.BAZA LIGJORE MBI TE CILEN ESHTË KERKUAR HARTIMI I PROJEKTIT NGA SHOQERIA.

Kjo leje kerkohet per shfrytezimin e mineralit gure gelqeror ne objektin "Pashkashesh", Berzhitë, Bashkia Tiranë, qarku Tiranë, zona nr.122/2, qe shoqeria "KELI INERTE" sh.p.k, ka aplikuar per marrjen e lejes mnerare si zone konkurruese.

Prodhimi qe mendohet te realizohet ne zonen minerare 100 000m³.

Sasia e prodhimit qe do te perpunohej 100 000 m³ ne vit

Vlera e investimit qe parashikohet per t'u kryer 250 000euro.

Vlera e produkteve minerare 1 200 000 000lek.

Vlera e rentabilitetit ekonomik (IRR) 54.7%

2.a. Niveli i parashikuar i investime.

Siç e theksuam me lart zona nr.122/2, ne objektin "Pashkashesh", njesia administrative Berzhitë, bashkia Tiranë, Qarku Tiranë. Investimet ne objekt do te jene ne masen 250 000 euro, te ndare ne 5 vitet e para qe ne menyre me te detajuar

2.b. Zona minerare e percaktuar sipas akteve ligjore nenligjore ne fuqi

Zona per te cilen kerkohet leje shfrytezimi eshte zona nr.212/2, per objektin e gelqeroreve "Pashkashesh", qe ka dale si zone e konkurruese ne planin vjetor 2024, nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.

Objektivat e aktivitetit

Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore te ketij instalimi te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones

Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

Vendodhja dhe karakteristikat fizike te projektit

Objekti i projektuar per shfrytezim ndodhet ne vendburirnin e gelqeroreve Pashkashesh, njesia administrative Berzhite, rrethi Tirane. Ne veri vendburimi kufizohet me zona te pa banuara, luginen e lumit Erzen rreth 3 km larg. Ne lindje mbi 2km ndodhet fshati Pashkashesh dhe lugina e perroit Zalle, dege e lumit Erzen, ne perendim pas rnalit Pashkashesh ndodhet fshati Pellumbas. Objekti ndodhet rreth 9.5 km nga rruga nacionale Tirane - Elbasan dhe 25km nga qyteti Tirane.

Vendburimi i gurit gelqeror kerkuar per shfrytezim nga subjekti "Keli Inerte" shpk, ndodhet ne afersi te fshatit Pashkashesh, ne te majte te rruges automobilistike Ibe - Klllojke.

Shtepite me te aferta te fshatit jane mbi 800m.

Midis fshatit dhe karrieres ndodhet nje Koder e pyllezuar, qe e mbron vend - banimin nga zhurmat pluhuri dhe gurët.

Ky objekt ben pjese ne planshenten topografike te shkalles 1 : 25 000 me nomeklature : K - 34 - 100 - B – d dhe ka keto kordinata :

PIKAT	Y	X
1	44 13 950	45 68 320
2	44 13 600	45 68 830
3	44 14 060	45 68 900
4	44 14 400	45 68 400

Siperfaqja e zones se kerkuar per shfrytezim eshte 0.256 km²

- Niveli i shfrytezimit eshte nga +730m deri ne +830 m mbi nivelin e detit
- **Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi**

Tabela e llogaritjes se rezervave gjeologjike, objekti i gelqeroreve "Pashkashesh", Tiranë

Nr.	Siperfaqja mes profileve m ²	Siperfaqja mes profileve m ²	Largesia mes profileve ml	Volumi I bllokut m ³	Pesha voluminoze T/m ³	Sasia ne Ton

km-I-I	14756	4918.6	78	383 656	2.4	920 774
I-I	14756	17 910	120	2 149 200	“	5 158 080
II-II	21064					
II- II	21064	22766	120	2 731 920	“	6 556 608
III-III	24468					
III-III	24468	23 881	120	2 865 720	“	6 877 728
IV-IV	23294					
IV-IV	23294	10 586	120	1 270 320	“	3 048 768
V-V	1868					
V-V	1868	622	25	1550	“	3 720
Shuma			583	9 402 366	“	22 565 678

$$S_k = 0.256\text{km}^2$$

Llogaritja e rezervave gjeologjike te objektit te gelqeroreve Pashkashesh, Tiranë.

Kufiri i poshtem i shfrytezimit eshte pranuar me kuote +730 m dhe kufiri i siperm +830 m

Sasi e rezervave gjelologjike te llogaritura ne tabelen e mesiperme perfaqson vellimin e pergjithshem te gelqeroreve, qe ndodhen brenda zones se shfrytezimit nga kuota +830m deri ne ate +730m .

Me poshte ne pjesen minerare do te jepet llogaritja e rezervave qe do te preken nga shfrytezimi dhe sasi e mbuleses dhe sterileve te tjera.

Rezervat e mbuleses

U muar nje trashesi mbulese 0.5m.

Siperfaqja e pergjithshme e karieres 256 000 m².

Volumi I mbuleses ($V_{mb}=256\ 000\ \text{m}^2 \times 0.5\ \text{m} = 128\ 000\ \text{m}^3$).

Humbjet dhe varfërimi

Nisur nga ndërtimi gjeologjik, litologjik dhe lëndor i vendburimit, të përshkruara imtësisht në kapitujt përkatës, gjatë procesit të shfrytëzimit, në këtë objekt nuk do të ketë humbje dhe varfërim ne permasa te tilla qe te japin influencia ne cilesine e lendes se pare dhe rezervat gjeologjike te nxjerrshme. Për shkak të veprimtarisë së erërave apo reshjeve, si ne procesin e prodhimit dhe te transportit, mund të humbasë një sasi pluhurash e grimcash të imta, e cila është konsideruar rreth 5 % (**pra koeficienti i humbjeve eshte llogaritur 5%**). Gjithashtu në objekt (në lëndën e parë të prodhuar) mund të hyjnë lëndë të huaja si dhera etj, në sasira te tilla qe jane konsideruar rreth 5 %.

Këto përbëjnë atë që quhet varfërim dhe **koeficienti i varferimit është pranuar 5 %**, i cili kompenson sasinë e humbjeve

5. MENYRA E PROPOZUAR E SHFRYTEZIMIT

Zgjedhja e menyres racionale të shfrytëzimit dhe njekohesisht zgjedhja e drejte e pajisjeve minerare duhet bërë duke u nisur nga lloji i mineralit që në rastin tonë është gur gelqeror, vetite fiziko mekanike të tij, forma e objektit dhe konditat hidrogjeologjike.

Vendburimi i gurit gelqeror ndodhet në sipërfaqe. Pako produktive e tyre ndodhet e zhveshur dhe në disa vende e mbuluar pjesërisht me një shtresë toke vegjetale me trashësi të vogël e mesatarizuar rreth 0.5m, e cila do të hiqet për të bërë zbulimin e gureve dhe do të depozitohet në vendin e përcaktuar.

Transheja (Rruga automobilistike e projektuar) plotëson kërkesat teknike për funksionimin normal të saj dhe do të jetë brenda zonës së shfrytëzimit.

Vendburimi është i vendosur në një terren kodrinor i cili krijon kushte shumë të përshtatshme për shfrytëzimin me qiell të hapur (karriere) dhe nuk ka asnjë problem për heqjen e ujërave pasi shfrytëzimi në fazën përfundimtare llogaritet pas 25 vitesh dhe llogaritet të jetë 800 m mbi nivelin e detit ose si kuote absolute +800m.

Për shfrytëzimi i gureve gelqerore do të bëhet me qiell të hapur (karriere) me shkallë të lartësisë 10m.

Për shfrytëzimin e shpatit ben të mundur shfrytëzimin nga njekohesisht në disa shkallë si drejtim nga lart poshtë, ku me rritjen e lartësisë shtohet numri i shkallëve në shfrytëzim duke ruajtur përrësine e shpatit të shkallës 70° dhe atë të shuarjes së karrierës 55 - 57°, ku sheshi baze në përfundim të gjithë karrierën është + 730 m mbi nivelin e detit. Për shfrytëzimi do të kryhet nga lart poshtë, nga horizonti +830m dhe do të përfundojë në horizontin +730 m në përfundim të objektit. Si fazë e parë për 25 vitesh shfrytëzimi do të jetë në sheshin +800m.

6. PERSHKRIMI I PROGRAMIT TE SHFRYTEZIMIT

6.1. Rezervat qe merren parasysh ne projektim per 25 vjet.

Rezervat e nxjerrshme si per rezervat gjeologjike do i llogarisim me matje kompiuterike duke perdorur metoden e prerjeve dhe do te perdoren te njejtat formula si ato qe perdorem me lart :

$$(1) V_R = \frac{S_1 + S_2}{2} \times L \quad (1);$$

$$V_R = \frac{S_1 + S_2 + \sqrt{S_1 \times S_2}}{3} \times L \quad (2)$$

$$V_R = 1/3 S \times L \quad (3)$$

Ne faqen vazhdim eshte tabela e rezervave.

Pasqyra e llogaritjes se rezervave gjeologjike të objektit (te nxjerrshme), qe do ti nenshtrohen shfrytezimit, sipas shkalleve, llogaritur me me menyren e prerjeve horizontale duke kryer matje per çdo profile (pjesa qe do te shfrytezohet deri ne horizontin +800m).

Nr	Nr. bl. shkalla	Kat Rez	Prerjet kufizuese (izoipsi)	Sipërfaqja në pr. kufizuese në m ²	Sipërfaqja mesatar në m ²	Lartesi e shkalleve izoipse ve kufizues ml	Form ula e përdorur	Volumi në m ³	Rezervat në ton
1	(1)	A	840	28 799	36 333	12	2	435 996	514 416
			S-830	43 867					
2	(2)		S-830	43 867	53 136	10	2	531 360	1 275 264
			S-820	62 405					
3	(3)		S-820	62 405	69 931	10	2	699 310	1 678 344
			S-810	77 458					
4	(4)		S-810	77 458	85 479	10	2	854 790	443 592
			S-800	93 500					
Shuma e rezervave nxjerrshme gjithsej								2 521 456	6 051 494

Siç del me afatin e ri qe ka ligji nr.10304 date 15.07.2010 ku afat eshte 25 vite prodhimi eshte planifikuar i tille qe ne fundin e lejes te kete perfunduar shfrytezimi plotesisht i 4 shkalleve dhe do te kete rreth 10% te rezervave ne shkallen e fundit, te kater (840–800)

Kjo gje eshte kushtezuar edhe nga VKM nr.364 date 04.05.20011” Per percaktimin e kritereve te vleres minimale te sipërfaqes se zones se lejuar minerare dhe te vleres minimale te investimit te prodhimit per nje leje minerare”, aneksi nr.2, ku prodhimi minimal vjetor nuk duhet te jete me i

vogel se $100\,000\text{ m}^3$. Rezervat që do të shfrytezohen u muaren $2\,521\,456\text{ m}^3$, sepse tregu ka kërkesa për rritjen e prodhimit shoqëria mund të rrisë prodhimin me miratimin e AKBN-së.

Llogaritja e volumit të mbuleses

S_z – Siperfaqja e zones së shfrytezimit

$$T_m = 0.50\text{ m}$$

$$V_m = S_z \times T_m = 256\,000\text{ m}^2 \times 0.50 = 128\,000\text{ m}^3.$$

$$\text{Humbjet në shfrytezim} = 5\% = 9402\,366\text{ m}^3 \times 0.05 = -470\,118\text{ m}^3$$

$$\text{Varferimi në shfrytezim} = 5\% = 9\,402\,366\text{ m}^3 \times 0.05 = +470\,118\text{ m}^3$$

Rezerva të nxjerrshme

$$R_{nx} = R_{gj} - V_m - H + V = 9\,402\,366\text{ m}^3 - 128\,000\text{ m}^3 - 470\,118\text{ m}^3 + 470\,118\text{ m}^3 = 9\,274\,366\text{ m}^3$$

Sa me sipër rezerva të nxjerrshme për objektin në fjalë janë $9\,274\,366\text{ m}^3$.

Llogaritja e koeficientit të zbulimit

$$K_z = V_m / R_{nx} = 128\,000\text{ m}^3 / 9\,274\,366\text{ m}^3 = 0.013\text{ m}^3 / \text{m}^3$$

$$\text{Prodhimi vjetor } P_v = 100\,000\text{ m}^3$$

Sqarojmë se prodhimi vjetor është marrë masiv ndërsa shkruar (i rrezuar shkon $140\,000 - 150\,000\text{ m}^3$)

Jetëgjatësia e karrieres

$$= R_{nx} / P_v = 9\,274\,366\text{ m}^3 / 100\,000\text{ m}^3 = \text{mbi } 25\text{ vite.}$$

Siç del me afatin e ri që ka ligji nr.10304 datë 15.07.2010 ku afat është 25 vite prodhimi është planifikuar i tillë i perfundon deri në sheshin +8000, pra shfrytezohen të 4 shkallet që jepen në gjendjen perfundimtare, por kjo nuk mundësinë e rritjes prodhimit sipas kërkesave të tregut. Kjo gjë është kushtezuar edhe nga VKM nr.364 datë 04.05.20011” Për percaktimin e kriterëve të vlerës minimale të sipërfaqes së zones së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit të prodhimit për një leje minerare”, aneksi nr.2, ku prodhimi minimal vjetor nuk duhet të jetë më i vogël se $100\,000\text{ m}^3$. Kapaciteti merret $100\,000\text{ m}^3$ sepse nga përvoja e deri tanishme ka dalë se tregu nuk thith më shumë, por për nevojë me të mëdha të tregut që mund të shfaqen në të ardhmen, kapaciteti prodhues në karriere mund shumëfishohet disa here.

6.2. Kushtet tekniko minerare

Formacionet shkëmbore mbi të cilat do të zhvillohet veprimtaria minerare, klasifikohen në grupin e I^{rtë} (shkëmbinj të forte), me rrezistencë në shtypje mbi 70-80 bar. Janë rrezistentë kundrejt grëritjes së tyre prej ujërave apo veprimeve mbi to, të agjentëve të ndryshëm atmosferikë. Qëndrueshmëria e tyre në shpatet e pjerrëta është e madhe, kur ato janë masivë. Kur janë të shtresëzuar, qëndrueshmëria e tyre varet nga keni i renies së shtresave në korelacion me pjerrësinë e shpatëve (relievit

6.3. Zgjedhja e menyres se shfrytezimit

Zgjedhja e menyres racionale të shfrytezimit dhe njekohesisht zgjedhja e drejte e pajisjeve minerare është bërë duke u nisur nga lloji i mineralit që në rastin tone është gur gelqeror, vetite fiziko mekanike të tij, forma e objektit dhe konditat hidrogjeologjike, por faktori kryesor percaktues janë pajisjet e makinerite që shoqëria disponon të cilat të detajuar do të trajtojmë më poshtë.

Vendburimi i gurit gelqeror ndodhet në sipërfaqe. Pako produktive e tyre ndodhet e zhveshur dhe në disa vende e mbuluar pjesërisht me një shtresë toke vegjetale me trashësi të vogël e cila do të hiqet për të bërë zbulimin e gureve dhe do të depozitohet në vendin e percaktuar.

Transheja e hapjes (Rrugës automobilistike) është bërë brenda kërkesave teknike për funksionimin normal të saj dhe është brenda zonës.

Vendburimi është i vendosur në një terren kodrinor i cili krijon kushte shumë të pershtatshme për shfrytezimin me qiell të hapur (kariere) dhe nuk ka asnjë problem për heqjen e ujërave pasi shfrytezimi në fazën e fundit llogaritet edhe pas fazës së parë që po projektojmë për një afat 25-vjeçar dhe llogaritet të jetë +840m mbi nivelin e detit ose si kuota absolute +800m.

Për shfrytezimi i gureve gelqerore do të bëhet me qiell të hapur (kariere) me shkallë të lartë 10m.

Pjerresia e favorshme e shpatit bën të mundur shfrytezimin nga njekohesisht në disa shkallë si drejtim nga lart poshtë, ku me rritjen e lartësisë shtohet numri i shkallëve në shfrytezim duke ruajtur pjerresinë e shpatit të shkallës 70° dhe atë të shuarjes së karrierës 55-57°, ku sheshi bazë e fundit është + 730m mbi nivelin e detit. Për shfrytezimi do të kryhet nga lart poshtë, nga horizonti +840 m dhe do të perfundojë në horizontin +730m me prodhimin e llogaritur 100 000m³ në vit për fazën e parë 25 vjeçare.

Perfundimisht shfrytezimi do të bëhet me punime sipërfaqesore, kariere

6.4 Variantet e hapjes së minierës, për rastin konkret karrierës së gurit gelqeror

Faktoret percaktues në variantin e hapjes

Në percaktimin e varianteve të hapjes së këtij vendburimi marrin në konsideratë:

- *Parametrat gjeometrike të zonës së shfrytezimit.*
- *Kuota e rrugës nacionale ekzistuese.*
- *Kuota me e sipërme e shfrytezimit me kariere.*
- *Pjerresia e terrenit brenda dhe në periferi të zonës së kerkuar.*
- *Dimensioni i karrierës në shtrirje*
- *Dimensioni i karrierës në rënie*
- *Lartësia e shkallës 10 m*
- *Varianti më i shkurtër për të lidhur horizontin e sipërm +830 m me rrugën kryesore që për rastin konkret është me kuotën +730 është rruga ekzistuese.*

Nga analiza e faktoreve të mesiperm dhe terreni i favorshëm që karakterizon zonën e kerkuar për shfrytëzim dhe rruga është e hapur deri në kuotën më të lartë. Vendi i depozitimit të sterileve është në krahun e poshtëm të rruges, brenda zonës, në cepin fundor të vendit të zhvillimit të karrierës, kështu krijohet mundësia për hapjen e objektit në kondita mjaft optimale.

Rruga kryesore (magjistrali) për të hapur objektin, të kalojë brenda kontureve të zonës që duhet të shfrytëzohet, dhe në çdo 10 m lartësi të hapen degezime për t’u futur në shkallën që do të shfrytëzohet.

6.5 Kapaciteti nxjerrës i minierës, regjimi i punës, nderresa në ditë.

Dite pune në muaj ose në vit.

Kapaciteti prodhues i karrierës është llogaritur 100 000 m³/vit për aresyën kryesore që diktohet nga nevojat që ka tregu dhe me këtë sasi prodhimi është shpallur fituese shoqëria në tenderin që është bërë këtë objekt.

Llogaritja e kapacitetit vjetor prej 100 000 m³/vit të karrierës mbështetet në :

- a) Rezervat e nxjerrshme të llogaritura.
- b) Koha e dhenies së lejes së shfrytëzimit që është për një periudhë mbi 25 vjeçare ku miratimi i programit vjetor bëhet çdo vit.
- c) Nevojat e tregut për gurë gelqeror.

Me kapacitetin 100 000 m³/vit sigurohet një jetegjatesi e karrierës prej gati dyfishin e afatit të vlefshmerisë së lejes që shkon mbi 90 vite. Në rastin konkret kishin:

$$9\,274\,366\text{ m}^3 / 100\,000\text{ m}^3 = \text{mbi } 25\text{ vite}$$

Rregjimi i punës

Në këtë karriere do të punohet me një nderresë në ditë, 8 ore pune në nderresë. Në një muaj do të punohet 22 ditë dhe në vit 264 ditë për 10 muajt që do të punohet në vite, pasi edhe tre muajt e dimrit do të punohet.

Në fazën e parë që janë 25 vite me prodhimin e planifikuar karriera shkon deri në kuotën +830 dhe sipërfaqja e karrierës që preket është 256 000m², me trashësi mbuluese 0.5m do të kemi një volum zbulimi 128 000m³. Për këtë fazë e mesatarizuar koeficienti i zbulimit është :

$K_{zb} = 256\,000 : 9\,274\,366 = 0.013\text{m}^3/\text{m}^3$. Bazuar në sipërfaqen që zbulon çdo shkallë vëllimin e rezervave që kanë shkallët dhe prodhimin vjetor zbulimi do të jetë si në tabelën e mëposhtme.

Parashikimi i prodhimit dhe zbulimit në vite.

Prodhimi dhe Zbulimi në vite	Njesia matëse	Zbulim dheu	Prodhim guri
Viti 1-re	m ³	1300	100 000
Viti 2-te	m ³	1300	100 000
Viti 3-te	m ³	1300	100 000
Viti 4-te	m ³	1300	100 000

Viti 5 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 6 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 7 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 8 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 9 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 10 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 11 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 12 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 13 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 14 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 15 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 16 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 17 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 18 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 19 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 20 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 21 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 22 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 23 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 24 ^{-te}	m ³	1300	100 000
Viti 25 ^{-te}	m ³	1300	100 000
SHUMA	m³	32 500	2 500 000

Zbulimet jane marre 1300m³ ne vitin e pare, per vitin e dyte 1300m³, vitin e trete 1300 m³, ne vitin e kater e te peste 1300m³. Ne shkallet e mesiperme eshte me shume dhe duke ulur ne kuote zvoglohen dhe u muar nje sasi mesatare prej 1300 m³/vit, siç duket nga tabela.

Puna ne kariere do te organizohet ne kete menyre:

Do te vazhdoje ne shkallen e pare qe eshte midis kuotave +(840-830) kur te jete riparuar rruga automobilistike, qe sherben si transhe prerese, nga rruga automobilistike nacionale deri ne objekt. Pas perfundimit te shfrytezimit te shkalles se pare do te filloje shfrytezimi i gurit gelqeror ne shkallen +(830-820) e keshtu me radhe i shkalles (820-810) dhe (810-800) , deri ne shkallen 740-730, qe eshte perfundimi I karrieres. Siç duket edhe nga ana grafike disniveli i hapjes se tansheve prerese nga njera tjetra do te jete 10m aq sa eshte lartesia e shkalleve

Per nevoja te nje volumi me te madh te punes do te punohet paralelisht ne dy fronte, te cilat krjohen me shfrytezimin nga qendra per ne drejtim te kufirit.

E gjithë sipërfaqja qe do te shfrytezohet eshte nje masiv shkembor kodrinor- malor dhe nuk perben problem per bujqesine.

Rezervat jane te konsiderueshme dhe garantojne prodhimin e kerkuar nga shoqeria.

6.6 Punimet kryesore te hapjes

Menyra e hapjes se transheve

Ne varesi nga detyra e transportit te mases se shkembinjve te shkriferuar menytrat e hapjes klasifikohen:

- Me transport
- Pa transport
- Te kombinuar

Menyra e hapjes se transheve me transport eshte me universale por me e kushtueshme. Ne rastin e ketij projekti karriera shtrihet ne relief kodrinor me shkembinj te qendrueshem, prandaj rekomandohet hapja e transheve pa transport pasi ka keto perparesi :

- Siguron shpejtesi me te madhe ne hapjen e transheve ne saje te shfrytezimit racional te mjetit te ngarkimit i cili shkarkimin e materialit e ben direkt ne anen e poshtme te transhese.
- Eshte menyre e thjeshte dhe ka siguri te larte ne pune.
- Krijon mundesi per fillimin e transhese ne disa segmente njekoheisht.
- Transhete do te jene me gjysem seksioni

Menyra e hapjes se karrieres konsiston ne lidhjen e transhese kryesore me rrugen qe lidh karrieren me ate nacionale. Transheja kryesore eshte zhvilluar brenda zones se shfrytezimit dhe vazhdone neper zone duke u ngjitur deri ne kuoten +840m. Transhete prerese jane orientuar me drejtim jugperendim – verilindje (te njanshme) me drejtim avancimi per ne kufirin verilindor te zones, ndersa radha e shfrytezimit nga larte poshte. Transheja prerese pothuajse kane ndjekur izhipset dhe pjerresia e tyre eshte 1-2%. Sipas ketij projekti transheja prerese kane nje gjatesi prej maksimumi 1290m. Transheja eshte hapur ne formacione te qendrueshme te cilat favorizojne kene favorizuar ne zgjedhjen e nje kendi skarpate relativisht te madh 70 – 72 grade dhe kendin e shpatit te karrieres rreth 57 grade. Volumet e germimit per ml transhe llogariten rreth 5-6 m³/ml per transhete me gjysem seksioni.

Menjehere duke qene se jane te kryera punimet e hapjes, ne shkallen perkatese do te filloje hapja e transhese prerese ne shkallen e siperme zgjerimi i saj ne te nje drejtim per te krijuar frontin e nevojshem per manovrimin e makinerive te shpimit, ngarkimit dhe transportit.

Hapja e transhese kapitale

Hapja e vendburimit eshte e bere me transhe kapitale brenda objektit (shiko Planimetria e punimeve te projektuara, rruget e hyrjes ne kariere dhe sheshi i depozitimit te sterileve) jane kryer pasi kjo zone eshte ish leja minerare nr.598/1.

Hapja e transhese prerese

Permasat e seksionit terthor, gjeresia e bazes se transhese jane percaktuar ne funksion te intensiteti te mjeteve qe levizin ne vartesi te prodhimit, gje qe lidhet kryesisht me gjeresine e saj, pasi do te sherbeje si rruge transporti. Veçori e ketyre transheve eshte se lartesia e tyre ne perfundim te shfrytezimit varet nga lartesia e shkalles dhe pjerresia pranohet nga 3-5 ‰ qe siguron rrjedhjen e ujrave jashte shesheve te punes.

Ne hapjen e transhese do te perdoret nje ngarkuesi mbi rrota, por nuk perjashtohet mundesia qe ne zona te caktuara qe kane shkemb kompakt te perdoret edhe shpimi i birave me çekiçe shpues 7655 tip kinez me diameter $\Phi 38-42$ mm dhe thellesi rreth 1.5-2 m. Thellesia e birave varet nga pozicioni ku behen ne lidheje me aksin e transhese dhe fillojne nga te cekta dhe shkojne dre 2 m ne krahun e siper te rruges. Lenda plasese do te jete amonit. Materiali shkembor qe permbush kushtet do te ngarkohet ne automjete dhe do te dergohet per ne destinacionin perfundimtar. Siç e kemi theksuar me siper transheja kryesore do te kete si seksion terthor trekendesh te çrregullt me seksion rreth (6.5-7.0) m², seksion i mesatarizuar dhe nje kend skrapate 60°.

Elementet kryesore te transhese

Madhesia dhe forma e seksionit terthor	gjysem seksioni
Pjerresia gjatesore	0-1 %
Gjeresia e transhese	4.5 -5 m
Rrezja minimale e serpentinave	15 m
Lartesia e skarpates nga ana e siperme	1.5 – 2.2 m
Numri i kalimeve	1 me vend nderrime
Kendi i pjerresise se faqes per shkembinj te forte	55 – 65 grade

Organizimi i punes ne hapjen e transhese

Organizimi i punes gjate hapjes se transhese synon ne arritjen e ritmeve te larta te avancimit duke respektuar siguri te larte ne pune. Proceset e punes qe do te zbatohen sipas nje radhe

Elementet kryesore teknike te rruges

- Shpejtesia e projektuar 20 km/ore.
- Numri i kalimeve nje, me vendzgerime.
- Gjeresia e rruges 4 -4.5 m.
- Rrezja minimale 15 m.
- Pjerresia gjatesore maksimale 8-10%.
- Lartesia e skarpates nga ana e siperme 1,5 m.

Elementet kryesore te serpentinave

Serpentina mund te ndertohen per rruget ndihmes brenda karrieres, per te shkurtuar kohen e transportit kryesisht per proceset jo kryesore dhe do te kene keto parametra:

- *Rrezja minimale* 15m

- *Pjerresia terthore* 2 %
- *Gjatesia e segmenteve rakordues* 20m
- *Zgjerimi i serpentines* 3m
- *Pjerresia gjatesore maksimale* 6%

Kendet e skarpates se siperme te rruges jane 60°-62° dhe mbushje ne krahun e poshtem 42°-45°. Materiali i prodhuar eshte zbanjuar ne anen e poshtme te rruges.

Sistemi i shfrytezimit

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit qe do te perdoret per shfrytezimin e objektit merren ne konsiderate keta faktore:

- Menyra e transportit te sterilizimit.
- Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit.
- Tipet e parashikuara te mjeteve te ngarkimit dhe transportit.

Ngarkimi i sterilizimit dhe pjeses se hequr nga zbulimi do te kryhet me ndihmen e ngarkuesit mbi rrota (tipi lopate e drejte mekanike) ekskavatorit. Shkriftimi do te kryhet me ndihmen e forces se lendes plasese dhe vetem zbulimi heqja e mbuleses vegjetale do te behet nga eskavatori.

Transporti i sterilizimit dhe materialit te rezuar do te behet me automjetet veteshkarkuese te kapacitetit 27-28 ton.

Bazuar ne sa me siper mund te perdoren keto sisteme shfrytezimi.

- Sistemi i shfrytezimit te thjeshte pa transport.
- Sistemi i shfrytezimit me transport me perdorimin e automjeteve per transport.

Sistemet e shfrytezimit qe do te perdoren do te jene me transport me perdorimin e automjeteve per te kryer kete transport deri tek sheshi i depozitimit te lendes se pare.

Bazuar ne faktoret e mesiperme sistemi i shfrytezimit qe do te perdoret si deri me tani ne kete karriere do te jete me transport me automjete dhe depozitimin e sterilizimit ne stiva te brendshme ne veriperendim te karrieres. Sterilizimi qe do te dale nga punimet e zbulimit, do te ngarkohet ne automjete me anen e ngarkuesit dhe do te transportohet ne vend-depozitimet brenda kufijve te karrieres.

Shfrytezimi do te vazhdoje nga lart-poshte. Kjo menyre lejon ne rradhe te pare zhvillimin e rregullt te punimeve, persa i perket shkalles se sigurise ne pune si dhe krijon mundesi per te punuar jo vetem ne nje shkalle por ne disa njekohesisht.

Elementet e sistemit te shfrytezimit

- Lartesia e shkalles se karrieres 10 m.
- Gjatesia e bllokut te shfrytezimit 150-250 m
- Gjatesia e fushes se karrieres 350 m
- Gjeresia e fushes se karrieres deri 583m

• Thellesia e karieres (Faza e pare)	40 m
• Thellesia ne perfundim te shfrytezimit	110m
• Kendi i shkalles se punes	70°
• Kendi i shuarjes se shkalleve	57°
• Gjeresia e sheshit te sigurimit	3m
• Prodhimi vjetor	100 000 m ³
• Prodhimi ditor	378.8 m ³
• Prodhimi i nderreses	378.8 m ³
• Rendimenti i punonjesve	185.5m ³ muaj/punonjes
• Volumi vjetor i sterileve (i mesatarizuar)	1300 m ³ /vit
• Volumi ditor i sterileve	4.9 m ³ /dite
• Koefiçienti i zbulimit	0.013 m ³ / m ³
• Koficenti i varferimit	5%
• Koficenti i humbjeve	5%

Gjeresia e sheshit te punes ne shkalle llogaritet me formulen me meposhtme:

$$L = C + 2R + C_1 + B \quad \text{ku:}$$

- L, eshte gjeresia e sheshit te punes
- C, largesia ndermjet bazes se poshtme te mases se shkrikeruar ose bazes se poshtme te shkalles dhe aksit te levizjes se automjetit ne meter.
- R, rrezja e kthimit te automjeteve
- C₁, Largesia nga aksi i rruges se levizjes se automjeteve deri tek vija e brezit te sigurimit mbi te cilat ndodhet vendosja e mjeteve te ngarkimit dhe transportit.

Nga ana tjetër $C = (K/2) + 1$ ku K- gjeresia e automjetit per efekt llogarites merret 3 m nga 2.5m qe eshte ne fakt.

Keshtu: $C = 3/2 + 1 = 2.5m$

C₁ llogaritet me formulen $C_1 = (K/2) + 1.5 = 3/2 + 1.5 = 3m$.

$R = 1.2 \times R_{\min}$ ku R_{\min} – rrezja minimale e ktheses se automjeteve, qe merret 10 m.

$$R = 1.2 \times 10 = 12 \text{ m}$$

$$B = H (\cotg \beta + \cotg \alpha)$$

Ku: H- Lartesia e shkalles eshte per rastin konkret 10m

β - eshte kendu i qendrusherise se shpatit, kendu i shuarjes

α - Kendu i pjeresise se shpatit te shkalles

Per rastin konkret qe po trajtojme kemi:

$$B = 10 (\cotg 57^\circ - \cotg 70^\circ) = 10 (0.65 - 0.37) = 2.8$$

Keshtu gjerësia e shkallës do të jetë $L = C + 2R + C_1 + B = 2.5 + (2 \times 12) + 3 + 2.8 = 32.3$ m.

Ne rastin konkret kjo gjerësi shërben për të krijuar sheshin normal në fillimin e shkallës, pastaj me vazhdimin e shfrytëzimit, marrjen e fetave të pjerrta, kjo gjerësi sheshi zmadhohet dhe shkon deri në thellësinë e gjithë rezervave të shkallës. Theksojmë se kjo gjerësi shërben edhe në rastin e variantit të shfrytëzimit të dy shkalleve njëkohësisht dhe është distanca minimale që mund të jenë ballat e shkalleve larg nga njëri tjetri në plan horizontal.

Gjerësia e hyrjes llogaritet me formulën $A \leq 1.5R_{ke}$

Ku : R_{ke} - është rreza e kapjes së eskavatorit. Për rastin konkret $R_{ke} = 9$ m

$$A \leq 1.5 \times 9 = 13.5 \text{ m}$$

Gjerësia e brezit të shpërndarjes së masës së shkriferuar llogaritet me formulën: $B_1 = (1 - 1.5) \times H$, ku për rastin tone rrezimi do të jetë me shkallë m

Keshtu do të kemi: gjerësia e brezit të shpërndarjes së masës së shkriferuar do të jetë:

$$B_1 = (10 - 15) \text{ m}$$

Radha dhe drejtimi i shfrytëzimit

Shfrytëzimi i gurit gelqeror do të kryhet me qiell të hapur (kariere) me lartësi shkallë 10 m. Shfrytëzimi normalisht në këto kariere do të bëhet nga lart – poshtë duke filluar nga horizonti + 840m duke thelluar në horizontin + 800m në thellësim të fazës së parë.

Është parashikuar që të krijohet mundësia e vendosjes së sterilit në horizontin +830m, sipas rruges, transhese së transhese së hapjes (rrugën kryesore që lidh rrugën nacionale me kuotën me të lartë të karrierës nga kuota +830 në +840, do të depozitohen dherat e masat shkëmbore të zbulimit, si dhe në pjesët e tjera të shkëmbit që nuk mund të përdoren për prodhimin e materialeve inerte.

Shfrytëzimi nga lart – poshtë do të fillojë mbasi të jenë kryer punimet e transhese së prerjes për shkallën e parë të dytë dhe të jetë bërë pastrimi i pakos produktive nga mbulesa vegjetale dhe sterileve në shkallën e sipërme.

Shkriftimi në masivin shkëmbor do të kryhet nga përdorimi i lëndës plasese, direkt dhe vetëm zbulimi do të bëhet nga forca mekanike e koves së eskavatorit.

Gjatesia e krahut të eskavatorit do të jetë e tillë që të plotësohet kushti $H/1.5 < H_{\text{krahut.eskav}}$, duke zbatuar nenin 486 të rregullores së teknikes së sigurimit për minierat e karrierat (Kapitulli i gjashtë, rregullat e shfrytëzimit në qiell të hapur)

Materiali i rrezuar nga lëndët plasese do të ngarkohet me eskavator në automjete vetëshkarkuese. Eskavatori do të ngarkojë në automjete dhe mbulesën vegjetale, e cila do të transportohet në sheshin +730. Rradha e shfrytëzimit do të jetë nga lart – poshtë.

Në vitin e parë do të kryhen punime transhete e prerjes në dy shkallët e sipërme hapje. Pasi të kryhet zbulimi në shkallën e sipërme në këto shkallë do të fillojë shfrytëzimi. Zbulimi do të vazhdojë të kryhet në horizontin e sipërm dhe pas thellësimin të saj do të vazhdojë në shkallët e

meposhtme. Ky zbulim do të konsistoje kryesisht në pastrimin e shpateve në gjatësi sa gjatësia e karrieres në dy shkallet e sipërme dhe në shkallet tjera në vijim sa gjatësia e karrieres.

Drejtimi i shfrytëzimit do të jetë veriperëndimi në drejtim të juglindjes për shkallën e parë, ndërsa te dytë dhe nga qendra në drejtimin e lindjes dhe perëndimi për dy shkallet e tjera.

Siç e trajtuam më sipër në shkallë do të ketë lartësi 10m. Rrezimi do të realizohet me feta të pjerreta ku gjerësia e një fete kushtëzohet nga numri i rreshtave që në rastin konkret është 8m dhe drejtimi i marrjes së saj do të perëndim-lindje.

Këndi i pjerrësisë α për shkallën do të jetë (70°) shiko anën grafike.

Prodhimi vjetorë e karrieres është $100\,000\text{ m}^3 : 264\text{ dp/vit} = 378.78\text{ m}^3/\text{dite}$

- **Burimet e shkarkimeve nga instalimi**

Humbje e tokës për kullotë

Sipërfaqja e përgjithshme që do të zëjë objekti gjatë shfrytëzimit është 0.124872 km^2 . Ajo nuk është e kultivueshme dhe nuk përfaqëson ndonjë kullotë. Në përfundim të shfrytëzimit kjo sipërfaqe do të sistemohet dhe mbillet me qelime ripërdorimit të saj. E gjithë zona do të mbulohet me formacionet deluviale të zbulimit duke mundësuar kështu, pas përpunimit, kultivimin e pemeve të ndryshme lokale dhe barishteve.

Si rrjedhim pas shfrytëzimit nuk do të kemi humbje të sipërfaqes për kullotë.

11.2. Humbje e pjerrësisë së tokës

Në projekt pjerrësia skarpatave të shkalleve është parashikuar të jetë $70^\circ - 72^\circ$. Kjo pjerrësi është më e madhe se ajo natyrore e terrenit të objektit. Mbas sistemit përfundimtar dhe mbushjes do të tentohet që ajo të ulet edhe 10° të tjera.

Humbja e pjerrësisë së tokës nga shfrytëzimi do të jetë e konsiderueshme.

11.3. Ndotja e tokës nga rrjedhjet

Në projektin e shfrytëzimit janë përcaktuar masa si pjerrësitë e shesheve të punës, kanalet e ndryshme në anë të rrugës etj të cilat do të mundësojnë dekantimi llumrave të pakta në ujra brenda kufijve të shfrytëzimit. Në stinën e thatë këto dekantime do të ngarkohen dhe transportohen në vendin e depozitimit të dherave.

11.4. Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta

Sasi e sterileve të zbulimit, perkohësisht do të depozitohet në sipërfaqet e parashikuara në projekt dhe më vonë do të ritransportohen dhe depozitohen në sheshet e shkalleve dhe në pjesën e zonës me kuotë të sipërme +830m dhe të poshtme +730m. Ato përfaqësohen nga deluvione të shkrifta që nuk përmbajnë elemente ndotes për ambientin. Këto depozitime janë fertile dhe do të shërbejnë më së miri për rigjenerimin e karrieres.

11.5. Ndotja e tokës nga depozitimi i llumrave

Gjate shfrytezimit të objektit nuk parashikohet depozitime llumrash . Ato, që në sasi shumë të pakta do të krijohen gjatë rreshjeve do të depozitohen brenda karrieres dhe do të riperdoren në rigjenerim .

11.6. Errozioni gjatë hapjes dhe shfrytezimit të objektit minerar.

Në projekt është parashikuar një radhe dhe drejtimi i tillë i shfrytezimi, që në kombinim me masat e tjera suplementare të mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojnë erozionin, shembjen dhe vithisjen e shapateve të karrieres dhe sipërfaqes së tokës rreth saj.

11.7. Bimet e ujit

Në zonë ku do të ushtrohet aktiviteti i shfrytezimit nuk ka asnjë lloj bime uji

11.8. Flora dhe fauna

Në zonën e shfrytezimit nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune që mbrohet me shtaus të veçante. Flora dhe fauna lokale nuk do të preket në shfrytezimi, mbasi sipërfaqja e objekti është pothuajse e zhveshur nga bimesia

Rigjenerimi i karrieres do të mundësojë mbjelljen e bimeve lokale

11.9. Trajtimi i ujrave

Teknologjia shfrytezimit të objektit nuk parashikon përdorimin e ujit . Ujrat e reshjeve do të dekantohen në gropa brenda zonës së shfrytezimit. Rrjedhja e me tejshme e tyre do të bëhet në përputhje me rrjedhjen natyrale të tyre me anë të një kanali në anë të rruges së hapjes deri në kanal në rrugës së poshteme

11.10. Zhurmat gjate punes se hapjes

Burimi kumuluar i zhurmave nga puna e njëkoheshme e makinerive në distancë 7 m nga to, është 180 dB. Duke marrë parasysh shprehjen e nivelit të intensitetit akustik të një zhurme me relacionin e më poshtëm :

$$L = 10 \lg(I_1/I_0) \text{ ku}$$

L - Niveli akustik i zhurmës të marrë në konsideratë .

I_1 - Intensiteti akustik i zhurmave të kumuluar

I_0 - Intensiteti akustik i referencës

Vlerësojmë se niveli akustik i zhurmës në rrugë është me i ulët se ai i zhurmës së një makine që kalon në të , praktikisht ai është 40-50 dB që i përgjigjet kushteve të një bisede me zë normal.

Vlerësojmë se niveli akustik i zhurmës në rrugë është me i ulët se ai i zhurmës së një makine që kalon në të , praktikisht ai është 40-50 dB që i përgjigjet kushteve të një bisede me zë normal.

Analiza e frekuencës të zhurmës të emetuar nga këto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen në mesataren e frekuencës 200-2000Hz , e cila është e pranueshme nga veshi i njeriut .

11.11. Pluhurat gjate procesit te punes

Me qëne se projekti parashikon rrezimin e materialit me përdorim të LP formacionet janë relativisht të forta nuk do të ketë lirime pluhurash .

11.12.Ndikimi ne mjedis i produkteve te lendeve plasese

Gjate zbulimit të shfrytezimit të objektit parashikohet përdorimi i lëndës plasuese në rreth 3700-3800 kg /vit ose mesatarisht 18 kg në ditë . Në projekt janë parashikuar të gjitha masat mbrojtëse si për flakerimin e copave , valen sizmike dhe zhurmat . Ndikimi i përdorimit të lëndës plasuese do të jetë i pakonsiderueshem .

11.13.Ndikim ne mjedis i gazeve te njeteve motorike

Gjate fazës së zbatimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazrave, lengjeve , mbetje toksike, helme të ndryshme dhe substanca të tjera të dëmshme të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisin për rreth duke përfshirë të gjitha llojet e bimëve dhe gjallesave të ndryshme

11.14.Prodhimi i mbeturinave dhe depozitimi i materialeve qe krijohet gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit

Gjate hapjes dhe shfrytezimit të objektit do të ketë depozitim paraprak të rreth 10000 m³ sterile të cilat do të kthehen në përfundim të shfrytezimit. brenda kufijve të karrierës.

11.15 Pastrimi rregullimi dhe rigjenerimi i pejsazhit

Planifikimi i zones;

Per shmagen dhe parandalimin e erozinit, shembjes se siperfaqes dhe vithisjeve te ndryshme, ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapesire i zones ne tersi dhe shkalleve te ndryshme te shfrytezimit ne vecanti.

Sistemimet, ndertimi i rruges lidhese, hapja dhe fillimi shfrytezimi i karrieres parashikohet te behet qe ne vitin e pare dhe te vazhdoje disa vjet .

Ne zonen e shfrytezimit hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit eshte parashikuar mbushja sistemimi, perpunimi dhe mbulimi i nje siperfaqeje prej rreth 0.124872km².

Gjate ushtrimit te aktivitetit dhe kryesisht ne vitet e fundit te tij, parshikohet trajtimi i te gjithë siperfaqes se shfrytezuar

Kjo siperfaqe e perfituar nga trajtimet e mesipërme do te jape mundesi minmale per rikultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme lokale, duke krijuar kushte per parandalimin e erozionit dhe permiresimit te pamjes se pergjitheshme te zones se shfrytezuar

Masat teknike,

Per parandalimin e erozionit, shembjes dhe vithisjeve te ndryshme, ne zonen e shfrytezimit subjekti parshikon, cdo vit, te kryeje punimet e me poshteme:

Depozitimi i tyre behet me qellim te parandalimit te erozionit te shpateve dhe per t'i paraprire mbjelljes se bimeve dhe pemeve karakteristike te zones;

Gjate ushtrimit te aktivitetit te shfrytezimit do te ruhen parametrat gjeometrike dhe gjeomekanike te shkalleve te shfrytezimit te parshikuar ne projekt;

Sistemimi, krefja dhe skarifikimi i skarpateve te shkalleve te shfrytezuar do te behet ne menyre sistematike, sipas parametrave gjeometrike te percaktuar ne pjesen perkatese te projektit;

Gjate shfrytezimit dhe ne perfundim te tij do te ruhen parametrat e pjeresise se shkalleve dhe te siperfaqeve te mbuluara per te lejuar rrjedhen normale te ujrave te rreshjeve dhe parndaluar grumbullimin dhe shpelarjen e siperfaqes se shfrytezuar dhe te mbuluar;

Masat estetike dhe ekologjike,

Gjate ushtrimit te aktiviteti te tij, subjekti i licensuar do te kryeje cdo vit proceset e me poshteme Sistemimin e skarpateve perfundimtare te shkalleve te shfrytezimit duke respektuar parametrat gjeomekanike dhe gjeometrike te tyre;

Lenien e brezave mbrojtës midis kufijeve te zones se shfrytezimit dhe siperfaqes tjeter (jashte kufirit te zones);

Sistemimin , perpunimin dhe mbulimin e siperfaqeve horizontale te shkalleve duke i kthyer ato ne forme brezaresh;

Krijimin e kushteve te pershtateshme per mbjelljen dhe kultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme lokale;

Mbjelljen e siperfaqeve te shkalleve me bime dhe peme , kryesisht me akacie dhe bime te tjera ,
te cilat jane karakteristike per zonen.

11.16. Demtime te siperfaqes nga operacionet e germimit

Ne perfundim te shfrytezimit karriera do te kete nje forme stadium te vogel me siperfaqe rreth 0.0539 km², e cila do te jete pjesisht e mbushur dhe sistemuar.

11.17. Ndikimi ne infrastrukturen e zones se objektit

Objekti gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit te tij do te lidhet me rruge me ate qe vjen nga Pashkasheshi ne Tiranë.

Transporti i materialit nga objekti i shfrytezimit dhe perpunimit ne destinacion do te behet me kamione 20-32ton duke perdorur rrugen e permendur me siper .

Aktiviteti i transporti qe do te kryet nga subjekti i shfrytezimit nuk e rendon trafikun aktual ne rruge, mbasi numuri i kamionave qe do te kalojne ne te eshte i vogel rreth 3000 kamiona gjate gjithe vitit ose 11-12 kamiona ne dite.

11.18. Ndikim ne shendetin e njerezve qe punojne ne objekt dhe te banoreve per rreth.

Punonjesit qe do te jene prezent ne objekt gjate shfrytezimit te tij do te jene te mbrojtur nga mjetet personale mbrojtese kundra pluhurit dhe zhurmave te cilat do te jene te kufizuar vetem brenda zones se shfrytezimit.

Si rrjedhoje e projektit te zhvillimit te shfrytezimit te mineralit ne kete objekt dhe ndikimeve pasuese mjedisore ne te, nuk do te kete dhe nuk priten ndikime ne shendetin e popullsise se zones dhe punonjesve te saj. Per pasoje nuk priten zhvendosje te tyre per shkak te ketij aktiviteti.

11.19. Ndikimi ne qarkullimin dhe transportin

Aktiviteti i transporti qe do te kryet nga subjekti i shfrytezimit nuk e rendon trafikun aktual ne rrugen qe shkon nga Pasjkashesh– Tiranë, mbasi numuri i kamionave qe do te kalojne ne te eshte i vogel 11-12 kamiona ne dite .

11.20. Plani i monitorimit te mjedisit

a) Plani i monitorimit

Me qene se kemi te bejme me shfrytezimin e mineralit ne siperfaqe ne shpatin e nje kodre dhe ne thellesi te saj nevojitet nje monitorim i vazhdueshem jo vetem ne siperfaqen e objektit qe do te shfrytezohet por dhe ne nje zone mbi 300m per rreth.

Plani i monitorimit do te konsistoje ne :

- Monitorimi i parametrave gjeometrike te shkalleve te shfrytezimit si: pjerresi, lartesia, kendi i skarpates, pjeresia e sheshit te punes si dhe parametrave gjeometrike te parshikuar ne projekt.
- Monitorimi i sjelljes se formacioneve ne kufijte e jashtem te karrieres dhe marrja e masave per parandalimin e levizjeve te mundeshme si shkarje, shembje ose vithisje .
- Monitorimi i zones se mundeshme te shperndarjes se pluhurit gjate aktivitetit te shfrytezimit
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatese te parashikuara ne projekt, per parandalimin e tij
- Monitorimi i sjelljes se bimesise ekzistuese ne zonen per rreth karrieres dhe marrja e masave per parandalimin e demtimit te tyre

- Monitorimi i siperfaqeve te mbushura me material dhe toke vegjetale per parandalimin e shplarjeve, grryerjeve, krijimin e gropave etj. Atje ku evidentohen demtime te kesaj zone do te merren masa per riparimin e tyre .
- Monitorimi i siperfaqeve te mbjella, pemeve dhe bimeve te kultivuara, ecurise normale e mbirjes dhe zhvillimit te tyre. Ne rastet kur verehet se ka demtime merren masa per zevendesime me fidane te rinj. Monitorimi i çdo siperfaqe te mbjelle do te vazhdoje per nje periudhe 4 vjeçare, kohe gjate se ciles bimet kane mare nje zhvillim te konsiderueshem dhe nuk kane me nevoje per sherbime.

Subjekti merr persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit.

Subjekti, gjithashtu, do te kete lidhje te vazhdueshme me Agjensine Rajonale te Mjedisit Tiranë, prane se ciles do te informoje periodikisht per mbarvajtjen e punes si gjate shfrytezimit ashtu dhe per mitorimn e parametrave te me mesem .

Masat per rigjenerimin e mjedisit

Masat per rigjenerimin hap pas hapi, krahas shfrytezimit te objektit konsistojne ne :

- Krijimin e siperfaqeve per mbjellje.
 - Sistemimin e materialit te mbuleses te depozituar paraprakisht ne kufijte e karrieres;
 - Mbjelljen e siperfaqeve te reja me fidane akacie dhe barishte te ndryshme ;
 - Mirembajtjen e siperfaqeve te mbjella;
- **Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme**
1. Teknikat më të mira të disponueshme " (TMD) do të thotë faza më efektive dhe e avancuar në zhvillimin e aktiviteteve dhe metodat e tyre te veprimit të cilat tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për të siguruar në parim bazat për vlerat limite të emetimeve të percaktuara per të parandaluar dhe ku nuk është e praktikueshme, në përgjithësi për të reduktuar emetimet dhe ndikimin i tyre në mjedis në tërësi:
 2. 'Teknika' përfshin te dyja si teknologjine e përdorur dhe mënyren në të cilën impianti është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, operuar dhe çmontuar.
 3. Teknikat me te mira te disponueshme' do të thotë ato qe jane te zhvilluara në një shkallë që lejon zbatimin në sektorin përkatës industrial, nën kushte ekonomikisht dhe teknikisht te zbatueshme, duke marrë parasysh kostot dhe përparësitë, nëse janë apo nuk janë përdorur ose prodhuar teknikat brenda territorit te pales në fjalë, për aq kohë sa ato janë mjaft te lejueshme per operatorin;

4. Me të mirë ' do të thotë më efektiv në arritjen e një niveli të përgjithshëm të lartë të mbrojtjes së mjedisit në tërësi. Në përcaktimin e teknikave më të mira të disponueshme, konsideratë të veçantë duhet t'i jepet, në përgjithësi, ose në raste të veçanta faktorëve të mëposhtëm, duke pasur parasysh kostot me të mundshme dhe perfitimet nga një masë dhe parimet e masës paraprake dhe parandalimit:
5. Proceset e krahasueshme, pajisjet apo metodat e funksionimit të cilat kanë qenë provuar me sukses në një shkallë industriale;
6. Përparimet teknologjike dhe ndryshimet në njohuri shkencore dhe të të kuptuarit;
7. Natyra, efektet dhe vëllimi i emetimeve në fjalë;
8. Datat e montimeve për instalimet e reja apo ekzistuese;
9. Koha e nevojshme për të futur teknikën më të mirë të mundshme;
10. Konsumi dhe natyra e lëndëve (përfshirë ujin) të përdorura në proces dhe efikasitetin e saj të energjisë;
11. Nevoja për të parandaluar apo zvogëluar në minimum ndikimin e përgjithshëm të emetimeve në mjedis dhe rreziqet për të;
12. Nevoja për të parandaluar aksidentet dhe për të minimizuar pasojat e tyre për mjedisin. Koncepti i teknikave më të mira të disponueshme nuk i drejtohet këshillimit të ndonjë teknike ose teknologjie të veçantë, por marrjes parasysh të karakteristikave teknike të impianteve në fjalë, pozitën e saj gjeografike dhe kushtet lokale mjedisore

MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Masat zbutese te ndikimeve negative ne mjedis gjate fazes se operimit

Ky kapitull do të trajtojë masat kryesore të propozuara që duhet të marrë investitori ose kompania zhvilluese për zbutjen apo shmangien e ndikimeve negative të analizuar në kapitujt me lart. Këto masa përfshijnë masa të përgjithshme, si dhe për minimizimin e impakteve negative.

Cfare	Si
Parandalim	<ul style="list-style-type: none"> - Instalimi korrekt i makinave, sipas skemes teknologjike te permiresuar - Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe veprimit - Kontroll i vazhdueshem dhe mirmbajtje e sistemit te djegies ne temperature te larte. - Sigurimi i sistemit te komandimit te pompave, filtrave dhe pastruesve te tjere; - Zbatimi rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj - Vezhgim dhe kualidim i vazhdueshem i te gjithe teknologjise se projektit, sistemi i qarkullimit te produktit, saracineska, tubo, valvola, tapa, guarnicione; - Testimi periodik i teknologjise dhe agregateve te saj
Kontroll	<ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash - Lagie e sheshit te punes dhe rrugeve te levizjes se kamioneve - Levizje e ngadalte e automjeteve - Larje e shpeshte e makinerive dhe kamioneve te punes, sipas nevojës. - - Mirembajtje e sistemit te gjelberimit.
Nderhyrje	<ul style="list-style-type: none"> - Riparim i menjehershem i difekteve dhe avarive teknologjike - Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhjesh te pa parashikuara sipas skemes tekonologjike - Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale - Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca) - Krijimi i nje Plani emergjencash per menaxhimin e situatave me rrezik ne mjedis
Administrimi	<ul style="list-style-type: none"> - Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjithe infrastruktures te uzines -Perdorimi dhe ruajtja e makinave dhe instalimeve sipas skemes dhe rregullave teknologjike. -Perdorimi racional i burimeve ujore dhe energjitike - Implementimi i politikave te sigurise dhe shendetit ne pune.

1.1 Masat per mbrojtjen e ajrit nga makinerite e transportit

Kontroll	<ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash - Levizje e ngadalte e automjeteve ne veprimtari - Larje e shpeshte e makinerive dhe makinave te punes
Nderhyrje	<ul style="list-style-type: none"> - Riparim i menjehershem i difekteve dhe avarive teknologjike - Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhesh te pa parashikuara sipas skemes. - Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale - Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca)
Administrim	<ul style="list-style-type: none"> - Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjithe infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike.

